

# Përtej numrave



**Performanca e prokurorisë në  
luftën kundër korrupsionit  
Janar - Mars 2017**

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i inancuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Lëvizjes FOL dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

# METODOLOGJIA

Duhet të theksojmë që në fillim se matja e performancës së Prokurorisë nuk është punë e lehtë. Për dallim nga gjyqësori, puna e të cilit matet me lëndë, puna e Prokurorisë matet kryesisht me persona. Kjo sepse Prokuroria investon kohë të gjatë në përgatitjen e një lënde për një person. Natyrisht, hetimi nuk është i njëjtë dhe ai ndryshon varësisht prej veprës penale për të cilën hetohet dhe varësisht se sa kompleks është rasti. Të gjitha këto dhe shumë të tjera ndikojnë në trajtimin e një rasti si dhe në kohëzgjatjen e tij deri në shndërrimin e tij në aktakuzë. Siç u pa nga raporti për gjykatat, për matjen e performances së gjyqësorit Lëvizja FOL ka përdorur formulat e Komisionit European për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ). Vetë CEPEJ-i nuk ka bërë matjen e efikasitetit të shërbimit prokurorial.

Megjithatë, pas analizës, FOL ka ardhur në përfundim se formulat nga CEPEJ për gjykatat janë të përdorshme edhe për matjen e efikasitetit të Prokurorive mbi bazën e statistikave zyrtare.

Matja nuk përfshin gjithë sistemin prokurorial dhe nuk përfshin të gjitha lëndët dhe llojet e veprave. Matja bëhet vetëm për një grup të veçantë të veprave penale më saktësisht për Kapitullin XXXIV të Kodit Penal të Kosovës – Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, nenet 422 –437.

Matja nuk tregon për cilësinë e lëndëve dhe cilësinë e punës së prokurorëve, cilësinë e shërbimit të administratës apo integritetin dhe profesionalizmin e prokurorëve.

Fushat në të cilat FOL do ta masë performancën e Prokurorisë janë si në vazhdim: 1) Fluksi i lëndëve, 2) norma e zgjidhjes së lëndëve, 3) norma e qarkullimit të lëndëve, 4) trendi i zgjidhje së lëndëve, 5) kohëzgjatja e trajtimit të lëndëve dhe 6) indeksi i lëndëve të grumbulluara.


*Ky raport i performances është i bazuar në statistikat zyrtare të publikuara nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK).*



## Në nivel qendror

Bazuar në metodën e CEPEJ-it, fluksi i lëndëve do të na tregojë se si qëndron raporti ndërmjet lëndëve të reja, lëndëve të zgjidhura dhe lëndëve në pritje.

Numri i lëndëve të reja nënkupton numrin e lëndëve që hyjnë në sistem dhe që kërkojnë trajtim; numri i lëndëve të zgjidhura është përgjigjia që jep sistemi i drejtësisë, pra numri i lëndëve që trajtohen. Lëndët që priten të zgjidhen ose lëndët e papërfunduara janë numri i lëndëve që mbeten për t'u trajtuar nga Prokuroria në një kohë të caktuar dhe si të tilla janë lëndë që barten.



Statistikat tre mujore për Prokuroritë Themelore dhe për Prokurorinë Speciale për periudhën **Janar-Mars 2017** për veprat penale korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare

## Në nivel rajonal



Prokuroritë Themelore, dhe Speciale	Njësia matëse: Kapitullin XXXIV të kodit penal të Kosovës	(PS=raste në fillim të periudhës, të trashëguara)	Raste të reja të hapura gjatë vitit kalendarik (I)	Lëndë në Punë (LP)	Lëndë të zgjidhura gjatë vitit kalendarik (R)	(PS lëndë të pazgjidhura në mbyllje të periudhës)
Prishtinë		595	102	697	28	614
Ferizaj		46	7	53	14	39
Mitrovicë		192	12	204	5	199
Prizren		71	27	98	48	50
Gjilan		45	22	67	26	41
Gjakovë		35	7	42	10	32
Pejë		39	25	64	27	37
Prokuroria Speciale		128	0	128	15	113



# Norma e zgjidhjes së lëndëve

## Në nivel qendror

Norma e zgjidhjes së lëndëve është tregues i performancës së punës së Prokurorive. Bazuar në performancën e treguar për tre mujorin e parë të vitit 2017, del se prokuroria ka punuar efektivisht mbi nivelin 100% në nivel qendror. Norma për tre mujorin e parë të vitit 2017 është **112%**.



Norma e zgjidhjes së lëndëve % =

$\frac{\text{lëndët e zgjidhura në fund të periudhës raportuese}}{\text{lëndët e reja gjatë periudhës raportuese}}$

x100

Norma e  
zgjidhjes së  
lëndëve për  
Janar - Mars 2017

112%

## Në nivel rajonal

### Norma e zgjidhjes së lëndëve për prokuroritë themelore dhe speciale

Njësia  
matëse:

Prokuroria  
Speciale

Prishtinë

Ferizaj

Mitrovicë

Prizren

Gjilan

Gjakovë

Pejë

Norma e  
zgjidhjes së  
lëndëve

Nuk aplikohet

27%

200%

41%

177%

118%

142%

108%



## Trendi i zgjidhjes së lëndëve

### Në nivel qendror

Një numër i madh i lëndëve vazhdojnë të barten nga viti paraprak duke bërë që sistemi të vonojë në dhënien e drejtësisë. Numri i lëndëve të bartura ndikon drejtpërdrejtë në performancën e prokurorisë edhe pse niveli i performancës është mbi 100%. Përlogaritja këtu është bërë duke marrë për bazë normën e zgjidhjes së lëndëve të treguar për tre mujorin e parë të vitit 2017.



$$\text{trendi} = \frac{\text{Numri i lëndëve në punë (LP)}}{\text{Numri i lëndëve të zgjidhura (R) - Numri i lëndëve të reja (I)}}$$




$$\text{trendi} = \frac{1354}{228 - 203} = 54 \text{ (vjet)}$$

**Nivelizimi i lëndëve me normën e zgjidhjes së lëndëve 112% do të arrihet në vitin 2071**



### Në nivel rajonal

Trendi i zgjidhjes së lëndëve bazuar në statistikat e periudhës Janar-Mars 2017 për shtatë prokuroritë themelore dhe speciale





## Në nivel qendror

Komisioni Europian për Efikasitetin e Gjyqësorit kërkon që sistemi i drejtësisë të raportojë një indikator të kohëzgjatjes e përfundimit të lëndëve i cili llogaritet në dy hapa. Së pari, numri i lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese pjestohet me numrin e lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese që njihet edhe si “norma e qarkullimit të lëndës”. Pastaj, kjo normë e qarkullimit të lëndës pjestohet me 365 për statistikave vjetore. Në këtë rast, numri me të cilin pjestohen lëndët është 90 si rezultat i statistikave tre mujore. Indikator i kohëzgjatjes së përfundimit të lëndëve (DT) mat se sa shpejtë sistemi i drejtësisë përfundon lëndët e pranuar në punë – që përkthehet me kohën që marrin lëndët për t’u zgjidhur. Norma e qarkullimit mat se sa shpejt sistemi (në këtë rast i Prokurorisë) i trajton lëndët që i pranon – që ndryshe i bie se sa shumë kohë merr sistemi për zgjidhjen e një rasti. Norma e ulët e qarkullimit të lëndëve përkthehet në kohëzgjatje më të madhe të zgjidhjes së lëndëve. Sa më i lartë të jetë numri i qarkullimit të lëndëve aq më shumë zvogëlohet pritja për drejtësi.




$$\text{norma e qarkullimit} = \frac{\text{Numri i lëndëve të zgjidhura në fund të periudhës raportuese}}{\text{Numri i lëndëve të pazgjidhura}}$$

Norma e qarkullimit të lëndëve për periudhën  
Janar - Mars 2017  
është 0.20

0.20

## Në nivel rajonal





## Në nivel qendror

Disposition Time- (DT) apo kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve, krahason numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese me numrin e lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese. 90 pjestohet me normën e qarkullimit të lëndëve të gjetur në hapin e parë në mënyrë që koha të përkthehet në numrin e ditëve



Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve =


90

Raporti i qarkullimit të lëndëve

Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve për periudhën  
Janar - Mars 2017  
është 450 ditë

450  
ditë

## Në nivel rajonal







## Në nivel qendror

Indeksi i lëndëve të grumbulluara përcaktohet nga numri i lëndëve të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese, i pjestuar me numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese. Një vlerë e lartë e këtij numri na tregon se duhet kohë më e gjatë për zgjidhjen e rastit. Për shembull, nëse numri është më i lartë se 1.0, gjykata nuk ka përfunduar aq lëndë sa ka pasur në fillim të periudhës raportuese. Kur vlera e indeksit është më e lartë se 1.0, lëndët barten për periudhat tjera raportuese dhe si rrjedhojë rritet numri i lëndëve të bartura.




Indeksi i lëndëve të grumbulluara =  $\frac{\text{numri i lëndëve të bartura në fillim të periudhës raportuese}}{\text{numri i lëndëve të zgjidhura në fillim të periudhës raportuese}}$

Indeksi i lëndëve të grumbulluara për periudhën  
Janar - Mars 2017  
është 5.0

5.0

## Në nivel rajonal



**MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK**  
**DANIDA** | INTERNATIONAL  
DEVELOPMENT COOPERATION



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Ky grant është inancuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i inancuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).